

Sqarim për media

Tiranë, më 01 Shtator 2023: Duke u nisur nga artikulli: **“Turistë edhe nga Koreja e Veriut! Nga e gjithë bota, vetëm 7 vende nuk e “shkelën” Shqipërinë”**, referuar hyrjes së shtetasve të huaj nga Koreja e Veriut, ju sqarojmë se:

Gjatë transmetimit të të dhënave nga burimi administrativ ka patur një lapsus i cili ka ndikuar në shifrat e publikuara në databazën statistikore të INSTAT në lidhje me këtë shtet.

Gjithashtu, INSTAT ka unifikuar kodifikimin e shteteve në databazën statistikore për publikimin “Lëvizjet e shtetasve” për të qenë konsistent me gjithë botimet e tjera.

INSTAT mirëpret komentet/sygjerimet/kritikat e çdo përdoruesi për të përmirësuar produktet statistikore.